FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.qpz.gov.al

Nr.58 14 maj 2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.246, datë 23.4.2009	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ……	2665
Vendim i Kuvendit nr.247, datë 23.4.2009	Për dhënien e autorizimit për procedim penal ndaj deputetit Nikollaq Neranxi ……	2665
Vendim i Kuvendit nr.248, datë 23.4.2009	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zonjës Mirela Fana anëtare e Gjykatës së Lartë ……	2666
Vendim i Kuvendit nr.249, datë 23.4.2009	Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për hetimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë e Tiranës ……	2666
Vendim i GJK nr.11, datë 23.4.2009	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.23, datë 11.4.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nr.30, datë 15.6.2005 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe nr.247, datë 28.4.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë ……	2667
Vendim i GJK nr.12, datë 28.4.2009	Me objekt: a) Shfuqizimin e pikës 1 të udhëzimit nr.18, datë 18.6.2008 të Ministrit të Financave, "Për disa shtesa në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", si i papajtueshëm me Kushtetutën b) Pezullimin e zbatimit të pikës 1 të udhëzimit nr.18, datë 18.6.2008 të Ministrit të Financave…… ……	2670
Vendim i ERE nr.29, datë 16.4.2009	Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2009 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike ……	2676

Udhëzim i KQZ nr.11, datë 21.4.2009	Për procedurat dhe afatin e heqjes së zgjedhësve që shërbejnë në Forcat e Armatosura e në forcat e Policise së Shtetit, nga listat e zgjedhësve të vendbanimit të tyre ……	2677
Udhëzim i KQZ nr.12, datë 21.4.2009	Për caktimin dhe përgatitjen e vendit të numërimit të votave, mënyrën e ngritjes së grupeve të numërimit dhe caktimin e tavolinave të numërimit të votave ……	2678
Udhëzim i KQZ nr.13, datë 22.4.2009	Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave ……	2684
Udhëzim i KQZ nr.14, datë 24.4.2009	Për kriteret për zgjedhjen e vendeve për afishimin e materialeve propagandistike në fushatën zgjedhore ……	2693
Vendim i KKRT nr.796, datë 17.4.2009	Për dhënie licence për televizionin vendor privat "ETV" …….	2694
Vendim i KKRT nr.797, datë 17.4.2009	Për dhënie licence për radion vendore private "Radio 4" ……	2695
Vendim i KKRT nr.798, datë 17.4.2009	Për dhënie licence për radion vendore private "Radio Jug" …….	2695
Vendim i KKRT nr.799, datë 17.4.2009	Për dhënie licence për radion vendore private "Radio Take 5"…	2696
Vendim i KKRT nr.800, datë 17.4.2009	Për dhënie licence për televizionin vendor privat "Tv Tele 4" ….	2696
Vendim i KKRT nr.801, datë 17.4.2009	Për zgjerimin e zonës së licencimit të operatorit televiziv privat vendor "Tv Ora" ……	2697
Vendim i KKRT nr.802, datë 17.4.2009	Për dhënie licence për televizionin vendor privat "Tv Jug" ……	2697
Vendim i KKRT nr.803, datë 17.4.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat satelitor "Tv Alsat" ……	2698
Vendim i KKRT nr.804, datë 17.4.2009	Për dhënie licence për televizionin vendor privat "Tv 7" ……	2698
Vendim i KKRT nr.805, datë 17.4.2009	Për dhënie licence për radion vendore private "Radio Lushnja"..	2699
Vendim i KKRT nr.812, datë 17.4.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor "Radio Alsat-1" ……	2699
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Shaqe Nazif Ramaj	2700

VENDIM
Nr.246, datë 23.4.2009

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT TÊ LARTË TË DREJTËSISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 147 të Kushtetutës, të nenit 4 pikat 2 dhe 7 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e KëshilLit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Lefterije Lleshi zgjidhet anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në vend të zotit Guxim Zenelaj.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.247, datë 23.4.2009

PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR PROCEDIM PENAL NDAJ DEPUTETIT NIKOLLAQ NERANXI

Në mbështetje të nenit 73 pikat 2 dhe 4 të Kushtetutës dhe të nenit 118 pika 4 e Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e autorizimit për procedim penal ndaj deputetit Nikollaq Neranxi, kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.248, datë 23.4.2009

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZONJËS MIRELA FANA ANËTARE E GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.6133, datë 14.4.2009,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Jepet pëlqimi për emërimin e zonjës Mirela Fana anëtare e Gjykatës së Lartë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.249, datë 23.4.2009

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E PRAKTIKAVE DHE PROCEDURAVE TË DHËNIES SË LEJEVE TË NDËRTIMIT NË BASHKINË E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, të neneve 4, 5, 8 e 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet komisioni hetimor i Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për hetimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë e Tiranës. II. Komisioni hetimor i Kuvendit ka për objekt të punës së tij hetimin e praktikave dhe procedurave të dhënies së lejeve të ndërtimit në Bashkinë e Tiranës nga viti 2007 e në vazhdim.

III. Komisioni hetimor i Kuvendit përbëhet nga 9 anëtarë, 5 nga shumica parlamentare dhe 4 nga opozita. Kryesia e komisionit, në bazë të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", i takon Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

IV. Komisioni hetimor përbëhet nga deputetët:

1. Ferdinand Xhaferri	Kryetar, PD
2.	Zëvendëskryetar, PS
3. Edi Paloka	anëtar, PD
4. Aldo Bumçi	anëtar, PD
5. Lalja Përnaska	anëtare, PD
6. Gjok Vuksani	anëtar, PD
7.	anëtar, Opozita
8.	anëtar, Opozita
9.	anëtar, Opozita

V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-javor nga data e miratimit të këtij vendimi.

VI. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij komisioni.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.11, datë 23.4.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Gjergji Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 18.12.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.28/14 Akti, që i përket:

KËRKUES: Elton Bazelli, përfaqësuar nga Av. Rustem Gjata, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokuror Hysen Keta, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr.23, datë 11.4.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr.30, datë 15.6.2005 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe nr.247, datë 28.4.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës europiane për të drejtat e njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuesit, që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr.23, datë 11.4.2005 ka deklaruar fajtor kërkuesin Elton Bazeli për veprat penale të vrasjes kundër dy ose më shumë personave të mbetur në tentativë, të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të falsifikimit të akteve të gjendjes civile, të parashikuara përkatësisht nga nenet 79, germa “dh”, 22, 278/2, 191/1 të Kodit Penal dhe e ka dënuar me 15 vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin nr.30, datë 15.06.2005, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit (vendimi nr.689, datë 6.10.2007).

Kërkuesi, bazuar në nenet 42 dhe 131, germa “f” të Kushtetutës, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e tri vendimeve të mësipërme, duke parashtruar këto shkaqe:

- Çështja është gjykuar nga gjykatat që nuk kishin kompetencë lëndore dhe si rrjedhojë është cenuar e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut.

- Moskalimi për shqyrtim i çështjes në seancë gjyqësore nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë përbën gjithashtu shkelje të parimit për një proces të rregullt ligjor. Përderisa në rekurs ishte ngritur çështja e moskompetencës lëndore të gjykatave për krime të rënda, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ishte i

detyruar t'i përgjigjej këtij pretendimi ligjor në përputhje me nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale.

Subjekti i interesuar parashtroi këto prapësime:

- Çështja e kompetencës është një çështje procedurale që rregullohet nga Kodi i Procedurës Penale dhe nuk lidhet me kushtetutshmërinë e vendimeve objekt kundërshtimi. Si e tillë, kjo çështje zgjidhet nga gjykatat e pushtetit gjyqësor dhe nuk përbën objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.

- Kërkuesit i janë garantuar të gjitha të drejtat, përfshirë edhe të drejtën e mbrojtjes, pasi ka qenë i përfaqësuar nga dy avokatë. Kërkuesi është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme që funksionon brenda sistemit gjyqësor të Republikës së Shqipërisë. Në gjykimin e akuzave ndaj tij është zbatuar çdo garanci dhe çdo detyrim që buron nga Kushtetuta.

II

Kërkuesi pretendon se është gjykuar nga gjykatat e krimeve të rënda për veprën penale të vrasjes kundër disa personave mbetur në tentativë, kur duhej të gjykohej nga gjykatat e zakonshme të rretheve gjyqësore dhe, si rrjedhojë, i është cenuar e drejta kushtetuese për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës e të nenit 6 të Konventës europiane "Mbi liritë dhe të drejtat themelore të njeriut".

Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata gjen me vend që të ritheksojë *se shprehja "gjykatë ... e caktuar me ligj" në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (vendimi nr.14, datë 17.4.2007 i Gjykatës Kushtetuese).* Vetë kompetenca lëndore e gjykatës është e lidhur ngushtë me kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete. Në këtë kontekst, fjala "ligj", sipas nenit 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave, ku kompetenca për gjykimin e çështjeve penale ka të bëjë me rrethin e akuzave, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të llojeve dhe niveleve të ndryshme.

Në përputhje me sa më sipër, Gjykata vlerëson se, nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është "e krijuar me ligj" sipas kuptimit të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane.

Bazuar në standardin e GJEDNJ *(çështja Jorgic v. Germany)*, Gjykata çmon gjithashtu se shprehja "*gjykatë e krijuar me ligj*", si element i procesit të rregullt ligjor i parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Europiane, reflekton parimin e shtetit të së drejtës të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, sipas të cilit e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

Nga gjykimi dhe materialet e çështjes rezulton se kërkuesi Elton Bazeli është akuzuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për disa vepra penale, mes të cilave edhe për krimin e vrasjes kundër dy ose më shumë personave, parashikuar nga neni 79 germa "dh" e Kodit Penal. Dosja e prokurorisë i ka kaluar për gjykim, sipas kompetencës lëndore, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në datën 3.9.2004, ndërsa më datën 22.10.2004 ka hyrë në fuqi ligji nr.9276, datë 16.9.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë". Sipas nenit 4 të këtij ligji, kompetenca lëndore e gjykimit të veprës penale të mësipërme nuk i përkiste më gjykatave të krimeve të rënda, por gjykatave të zakonshme të rretheve gjyqësore. Megjithëse ligji që ndryshoi kompetecën lëndore kishte hyrë në fuqi para gjykimit të çështjes objekt kërkese dhe megjithëse ai nuk përmbante asnjë dispozitë tranzitore për mënyrën se si do të veprohej për çështjet e regjistruara në gjykatat e krimeve të rënda, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ajo e Apelit për Krime të Rënda, si dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e dërguan çështjen në gjykatat e zakonshme të rretheve gjyqësore, por e mbajtën dhe e shqyrtuan vetë atë.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr.106, datë 27.5.2002 për kushtetutshmërinë e një procesi civil, është shprehur se *në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe*, pra kur vetë ligji ka parashikuar dispozita procedurale tranzitore.

Të njëjtin qëndrim Gjykata Kushtetuese ka mbajtur dhe në çështjet që lidhen me gjykimet penale në gjykatat e sistemit gjyqësor, pasi të drejtat dhe garancitë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor i janë njohur dhe dhënë procesit në vetvete, pa e dalluar atë në proces penal apo civil. "Është parim i njohur e i pranuar se ndryshe nga e drejta penale materiale, ku zbatohet parimi se ligji i ri nuk ka fuqi prapavepruese, me përjashtim të rasteve kur ai është në favor të të pandehurit, në të drejtën procedurale penale vepron parimi, sipas të cilit ligji i ri ka fuqi edhe ndaj marrëdhënieve procedurale të lindura para hyrjes së tij në fuqi, për çështje që gjenden në hetim apo gjykim, me përjashtim të rasteve e për një kohë kur vetë ligji shprehimisht ka vendosur" *(vendimi nr.11, datë 19.09.1995 i Gjykatës Kushtetuese).* Bazuar në këtë standard kushtetues, si dhe në faktin se në ligjin nr.9276, datë 16.9.2004, që ndryshoi kompetecën

lëndore të gjykatave të krimeve të rënda, nuk parashikoheshin dispozita tranzitore për çështjet që ishin regjistruar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda apo ishin duke u gjykuar nga gjykatat e krimeve të rënda përpara këtij ligji, arrihet në përfundimin se këto të fundit nuk kanë qenë kompetente për të shqyrtuar akuzat e ngritura ndaj tij.

Kuptimi i kompetencës si kufi i juridiksionit lind nga shumëllojshmëria e organeve që ushtrojnë këtë juridiksion, të parashikuara nga rendi juridik, si dhe nga kërkesa që rrjedh prej këtij të fundit për të ndarë këtë pushtet midis organeve shtetërore. Në këtë kuadër, kompetenca e gjyqtarit është kufiri i fundit që përcakton fushën e juridiksionit brenda të cilit ai është i detyruar që të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar.

Problemet e zbatimit dhe të intepretimit të ligjit, duke përfshirë edhe dispozitat për kompetencën, u takojnë në parim gjykatave të pushtetit gjyqësor. Megjithatë, duke u nisur edhe nga jurisprudenca kushtetuese, tejkalimet e kompetencave mund të merren në shqyrtim prej kësaj Gjykate kur ka patur një shkelje të tillë të ligjit procedural që ka cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Detyrimi i respektimit nga gjyqtari të kufirit të kompetencës është ndër të tjera parakusht për të mos lejuar që shumë gjyqtarë të ushtrojnë të njëjtin pushtet me vendime për një fakt të caktuar, duke cenuar parimin kushtetues të ligjshmërisë apo të gjykimit të një personi dy herë për të njëjtën vepër ***(ne bis in idem)***, të parashikuar përkatësisht në nenet 4/1 dhe 34 të Kushtetutës. Prandaj, për çdo rast dhe çështje të mundshme, ligji ka parashikuar një gjykatë kompetente për të gjykuar.

Gjykatat për krime të rënda, sipas nenit 2/2 të ligjit nr.9110, datë 27.7.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda", janë hallka të sistemit gjyqësor që shqyrtojnë në shkallë të parë dhe të dytë krimet me rrezikshmëri të lartë, të përcaktuar në ligj. Në kundërshtim me pretendimin e subjektit të interesuar, shqyrtimi i një çështje nga një gjykatë jo kompetente nuk përbën në çdo rast vetëm një shkelje procedurale, por ka të bëjë edhe me respektimin e të drejtës kushtetuese për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Marrja nga një gjykatë e kompetencës që i takon me ligj një gjykate tjetër, mund të bëhet vetëm nëse e lejon ligji dhe vetëm nga gjykatat që ai cakton. Ligjvënësi, me shtesat dhe ndryshimet e bëra, ndërsa ka parashikuar në kodet e procedurave penale e civile pasojat e mosrespektimit të kësaj ndarjeje, nuk ka parashikuar ndonjë përjashtim për gjykimin e ndonjë çështjeje nga gjykatat e krimeve të rënda kur ajo sipas ligjit i takon të gjykohet nga gjykatat e zakonshme të rretheve gjyqësore.

Mosrespektimi i kompetencës lëndore e bën vendimin gjyqësor absolutisht të pavlefshëm dhe pretendimi për respektimin e kësaj kompetence mund të ngrihet si nga i pandehuri/i gjykuari, ashtu edhe kryesisht në çdo fazë të procesit. Në ndryshim nga kompetenca lëndore, akti i dhënë në mungesë të kompetencës tokësore është një akt relativisht i pavlefshëm dhe deklarohet si i tillë nga gjykata mbi kërkesën e palëve, bërë para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor.

Sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe ajo e Apelit për Krime të Rënda, duke gjykuar vetë çështjen për një vepër penale që i takon kompetencës së gjykatave të zakonshme të sistemit gjyqësor, kanë zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

2. Në ankimin e bërë në Gjykatën e Apelit dhe në rekursin e paraqitur në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, kërkuesi, duke kundërshtuar dënimin e dhënë ndaj tij, ka pretenduar se duhet të gjykohej nga gjykatat e zakonshme të rretheve gjyqësore dhe jo nga gjykatat e krimeve të rënda.

Lidhur me këtë pretendim, Gjykata, duke u nisur nga përmbajtja e nenit 135 të Kushtetutës, vlerëson se Gjykata e Lartë, si organi më i lartë i pushtetit gjyqësor, ka për detyrë funksionale që të mbajë të gjitha gjykatat brenda kufijve të kompetencave të tyre (sidomos kompetencës lëndore) duke zgjidhur edhe mosmarrëveshjet midis tyre. Pretendimi i mungesës së kompetencës lëndore, i parashtruar si në gjykatat e sistemit gjyqësor, ashtu edhe në këtë Gjykatë, është i rëndësishëm për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në ato gjykata. Gjykata e Lartë duhet të investohej në shqyrtimin e rekursit dhe të mbante një qëndrim të shprehur se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë *(shih vendimin nr.41, datë 29.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese).*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.23, datë 11.4.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nr.30, datë 15.6.2005 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe të vendimit nr.247, datë 28.04.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Sokol Berberi, Sakol Sadushi.

VENDIM
Nr.12, datë 28.4.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 28.1.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.36/21 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve, përfaqësuar nga avokatët Maksim Haxhia e Envi Hiçka, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

Ministria e Financave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: a) Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i pikës 1 të udhëzimit nr.18, datë 18.6.2008 të Ministrit të Financave, “Për disa shtesa në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

b) Pezullimi i zbatimit të pikës 1 të udhëzimit nr.18, datë 18.6.2008 të Ministrit të Financave.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 118, 116, 131 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 45, 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, përfaqësuesit e Shoqatës së Shoqërive të Hidrokarbureve, që kërkuan pranimin e kërkesës, përfaqësuesen e subjektit të interesuar, që kërkoi rrëzimin e saj, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në datë 18.6.2008, Ministri i Financave ka nxjerrë udhëzimin nr.18, datë 18.6.2008 “Për disa

shtesa në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar". Ky udhëzim i ri shton dy skema të veçanta për tatimin e furnizimeve: skemën e karburanteve dhe skemën e cigareve.

Pika 9.4 e shtuar e udhëzimit nr.18 bën rregullimin e regjimit fiskal të furnizimit të karburanteve. Kjo pikë, ndër të tjera, parashikon se regjimi fiskal përcaktohet në mbështetje të nenit 11 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (ligji për TVSH-në), të ndryshuar. Importuesit dhe prodhuesit që janë furnizuesit primarë konsiderohen si kryesorë, ndërkohë që operatorët që furnizohen prej tyre konsiderohen si agjentë. Agjenti paraqitet si përfaqësues i kryesorit, duke kryer një ndërmjetësim të konsideruar si furnizim shërbimi dhe që është i tatueshëm si i tillë."

2. Në datën 9 shtator 2008, Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve (ShShH) iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për të shfuqizuar dhe pezulluar pikën 1 të udhëzimit nr.18, datë 18.6.2008 të Ministrit të Financave.

Kërkuesi pretendon se:

- Udhëzimi cenon parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të drejtën e pronës dhe të ekonomisë së lirë të tregut, të mbrojtura nga neni 11 i Kushtetutës, pasi parashikon që mes furnizuesve të karburanteve të ketë vetëm kontratë agjencie, duke mos i lënë mundësi subjekteve të zgjedhin lirisht kushtet e marrëveshjes së tyre. Kështu, shitësit me pakicë nuk mund të jenë zotërues të mallit.

- Udhëzimi kufizon lirinë ekonomike dhe ky kufizim është bërë pa ligj dhe pa pasur në konsideratë asnjë interes të rëndësishëm publik.

- Udhëzimi nuk respekton kriteret e nenit 118/1 të Kushtetutës që detyron nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e përcaktuara me Kushtetutë; të nenit 118/2, sipas të cilit ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si edhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. Ligji për TVSH-në, në asnjë pjesë të tij, nuk i jep kompetencë Ministrit të Financave të bëjë një rregullim kaq të detajuar siç është rasti i marrëdhënieve mes furnizuesve të hidrokarbureve.

- Udhëzimi duhet pezulluar për shkak të pasojave të pariparueshme dhe dëmit ekonomik që ai sjell për kërkuesit.

Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave, parashtruan se kërkesa duhet rrëzuar pasi:

- Udhëzimi nuk cenon nenin 11 të Kushtetutës, pasi ka dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit të TVSH-së. Nëse ka kufizim të lirisë ekonomike atë e ka vendosur vetë ligji i vitit 1995 mbi TVSH-në. Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion ta vlerësojë kushtetutshmërinë e ligjit pasi ka kaluar afati 3-vjeçar i përcaktuar në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Kalimi i këtij afati i jep këtij ligji karakterin e sigurisë juridike dhe prezumon vlefshmërinë kushtetuese të tij.

- Ky kufizim ligjor ka dalë i diktuar nga nevojat publike për shmangien e informalitetit dhe evazionit fiskal. Këto janë arsye të rëndësishme publike që justifikojnë kufizimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike. Shkalla e lartë e informalitetit dhe e evazionit fiskal në furnizimin e kategorive të veçanta (edhe të karburanteve, sipas statistikave të Ministrisë së Financave), krahasuar me kufizimin për vendosjen e skemave të veçanta, tregon se përmbushet kriteri i proporcionalitetit të ligjit mbi TVSH-në.

- Udhëzimi nr.18 nuk cenon nenin 118 të Kushtetutës. Udhëzimi ka dalë në kuadrin e rezervës ligjore absolute. Neni 35 i ligjit për TVSH-në parashikon se Ministri i Financave është përgjegjës për zbatimin e ligjit. Për zbatimin e ligjit, Ministri i Financave nxjerr udhëzimet përkatëse. Ndërsa neni 10 parashikon se Ministri i Financave cakton me udhëzim nëse një furnizim është furnizim mallrash apo shërbimesh.

- Bazuar në nenin 102 pika 4 të Kushtetutës, Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë duke nxjerrë urdhra dhe udhëzime.

II

1. Lidhur me legjitimitetin e Shoqatës së Shoqërive të Hidrokarbureve për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese sipas objektit të kërkesës

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka interpretuar, në jurisprudencën e saj, kriteret kushtetuese për legjitimimin e organizatave si subjekte që mund ta vënë atë në lëvizje (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9/200,; nr.11/200,; nr.35/2007, nr.41/2007, nr.9/2008*). Shoqatat ose organizatat e tjera janë përcaktuar në nenin 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007*). Ato kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të

ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak.

Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.810, datë 28.10.2003. Anëtarët e shoqatës janë shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve në Shqipëri. Në statutin e Shoqatës parashikohet, ndër të tjera, se qëllimi kryesor i shoqatës është: "*përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të përbashkëta të anëtarëve në kuadrin e zhvillimit të tregut të hidrakarbureve"*. Kërkuesi është organizatë që mbron interesat ekonomike të anëtarëve të tij, të cilët janë persona juridikë që ushtrojnë aktivitet ekonomik në tregun e hidrokarbureve. Veçanërisht kuadri ligjor tatimor që lidhet me tregun e hidrokarbureve dhe që është rregulluar me skemë të veçantë sipas udhëzimit nr.18, datë 18.6.2008 të Ministrit të Financave paraqet rëndësi për këta tatimpagues, pasi këto dispozita ligjore ushtrojnë një ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetin ekonomik të anëtarëve të shoqatës. Në këtë kuptim, pika 1 e udhëzimit nr.18, e cila përcakton regjimin fiskal të furnizimit të karburanteve dhe në veçanti llojin e furnizimeve dhe furnizuesve si kryesorë dhe si agjentë në treg, ka lidhje të drejtpërdrejtë me lirinë e veprimtarisë ekonomike të anëtarëve të shoqatës kërkuese.

2. Lidhur me kërkesën për pezullimin e zbatimit të pikës 1 të udhëzimit, objekt i kërkesës

Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të pikës 1 të udhëzimit nr.18, datë 18.6.2008 të Ministrit të Financave. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", u vendos rrëzimi i kërkesës. Gjykata nuk gjeti argumente bindëse për mundësinë e cenimit të interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të pikës 1 të këtij udhëzimi.

3. Lidhur me pretendimin se udhëzimi, objekt i kërkesës, cenon parimin kushtetues të lirisë së veprimtarisë ekonomike

Kërkuesi pretendon se pika 1 e udhëzimit objekt shqyrtimi cenon parimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, të drejtën e pronës dhe ekonominë e lirë të tregut, të mbrojtura nga neni 11 i Kushtetutës, pasi në këtë akt parashikohet që mes furnizuesve të karburanteve të ketë vetëm kontratë agjencie, duke mos u lënë mundësi subjekteve të zgjedhin lirisht kushtet e marrëveshjes së tyre.

Gjykata e ka sqaruar gjerësisht konceptin e lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës. Sipas saj kjo liri nënkupton kryesisht të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe të shërbimeve. Forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton të drejtën e pronës, lirinë e qarkullimit të fuqisë punëtore, të kapitalit dhe të mallrave pa asnjë kufizim dhe se individi ka të drejtë të punojë, të prodhojë, të konsumojë dhe të investojë në çdo mënyrë që i pëlqen dhe kjo liri duhet të mbrohet nga shteti. Liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete shumë të drejta dhe liri si: liria e biznesit ose aftësia për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, liria e tregtisë ose mungesa e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, liria monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të çmimit, liria fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende të lirë nga ndërhyrja e shtetit, liria e investimit dhe e qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht e kapitalit të huaj, liria financiare dhe pavarësia nga kontrolli shtetëror, liria e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 19.3.2008*).

Gjykata është shprehur se liria e veprimtarisë ekonomike përmban edhe detyrimin e shtetit që, nëpërmjet ligjvënësit, të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie, me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i të mirës së përbashkët. Ky detyrim për rregullim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara. Vetëm shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet që natyrshëm mund t'i mbartë me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike (*shih vendimin nr.10, datë 19.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata ka sqaruar edhe kriteret në bazë të të cilave shteti mund të ndërhyjë për të rregulluar ushtrimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike sipas këtij neni të Kushtetutës. Ajo është shprehur se, nisur nga struktura e Kushtetutës, e veçanta e nenit 11 paragrafi 3 është se ai nuk është parashikuar në grupin e të drejtave dhe lirive të tjera, por në pjesën ku parashikohen parimet themelore mbi të cilat mbështetet organizimi dhe funksionimi i shtetit. Kushtetutbërësi ka preferuar ta konsiderojë lirinë e veprimtarisë ekonomike së pari, si parim bazë të sistemit ekonomik të Republikës së Shqipërisë.

Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar cenimin ose jo të lirisë ekonomike duke iu referuar edhe

përmbajtjes së nenit 17/1 të Kushtetutës, e cila shtrihet ndaj të gjitha të drejtave dhe lirive të parashikuara në të, sipas të cilit "kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë". Kjo dispozitë, përveç arsyes publike, të cilën e gjejmë edhe tek neni 11/3, përmban detyrimin për të respektuar edhe kritere të tjera, si: kufizimi për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë. Parimi i njohur i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte apo lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.3.2008)*.

Bazuar në standardet e interpretimit të shprehura më sipër, Gjykata vlerëson fillimisht ekzistencën ose jo të një kufizimi nga ana e udhëzimit të Ministrit të Financave. Vlerësimi përfshin elementet nëse kufizimi i pretenduar është bërë sipas kritereve të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë, pra me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

Gjykata e ka sqaruar edhe më parë kuptimin e shprehjes "vetëm me ligj". Shprehja "vetëm me ligj" ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në diskrecion vetëm të Kuvendit dhe jo të organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave. Në këtë përfundim, arrihet edhe duke iu referuar fjalës "vetëm" që përmendin nenet 11/3 e 17/1 të Kushtetutës. Përdorimi i kësaj fjale nuk është i rastit, por për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit. Gjykata Kushtetuese ka çmuar se shprehja "vetëm me ligj" referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla, cenon kompetencat e këtij organi (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 11.7.2006*).

Duke iu referuar kushteve të nenit 17/1 në lidhje dhe me nenin 11/3 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson edhe dy kritere të tjera: parimi i interesit publik dhe parimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes legjislative, të cilët, si rregull, bashkërendohen dhe plotësohen nga njëri-tjetri. Lidhur me interesin publik, Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar se pranohen si kufizime të arsyeshme të lirisë së veprimtarisë ekonomike iniciativat e ligjvënësit, të cilat shërbejnë për një rregullim të tregut apo interesave të një shteti social. Këto masa të ligjvënësit mund të jenë të shumëllojshme, madje edhe të karakterit monetar, si p.sh. vendosja e tatimeve dhe taksave, e cila konsiderohet në vetvete si një lloj kufizimi. Është konsideruar në përgjithësi i mjaftueshëm garantimi i mundësisë së individit për të zgjedhur lirisht fushën e veprimtarisë së tij (iniciativa ekonomike) dhe për të realizuar idetë e tij mbi aktivitetin ekonomik që ai ka zgjedhur. Ajo që ka rëndësi është që thelbi i aktivitetit të individit të mos cenohet deri në atë masë sa të bëhet i pamundur ushtrimi i tij (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.3.2008*).

Udhëzimi, objekt i shqyrtimit kushtetues, është një instrument që lidhet me zbatimin e regjimit fiskal, konkretisht të TVSH-së, në fushën e furnizimit të karburanteve. TVSH-ja është pjesë e sistemit financiar të Republikës së Shqipërisë. Detyrimi për pagimin e tatimeve dhe taksave, apo detyrimeve të tjera financiare, është detyrim i parashikuar nga neni 155 i Kushtetutës, sipas të cilit "Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj". "Buxheti i Shtetit krijohet nga të ardhurat e mbledhura prej taksave, tatimeve dhe detyrimeve të tjera financiare, si dhe prej të ardhurave të tjera të ligjshme" (neni 157 i Kushtetutës). Gjykata ka theksuar se qëllimi i sistemit tatimor është mirëqenia e përgjithshme, që do të thotë e individëve dhe e komunitetit në përgjithësi, si dhe përmbushja e objektivave socialë të shtetit. Dispozitat e neneve 155 dhe 157 të Kushtetutës, të cilat konsolidojnë sistemin buxhetor dhe përcaktojnë burimet e krijimit të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, sanksionojnë detyrimin kushtetues për të paguar detyrimet tatimore. Taksat dhe tatimet nuk janë detyrime të negociueshme dhe mblidhen nga organet tatimore, me mënyrat e përcaktuara me ligj. Marrëdhëniet e tatim-taksave janë marrëdhënie ligjore detyrimi ndërmjet shtetit dhe tatimpaguesve dhe si të tilla ato mund të përcaktohen vetëm me ligj (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.16, datë 25.7.2008*).

Bazuar në parashikimet e ligjit për TVSH-në, Gjykata vëren se udhëzimi nr.18, datë 18.6.2008 i Ministrit të Financave është një akt i dalë në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar". Neni 35 paragrafi 1 i këtij ligji parashikon se Ministri i Financave është përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Ndërsa neni 35 paragrafi 3 parashikon se, për zbatimin e këtij ligji, Ministri i Financave nxjerr udhëzimet përkatëse. Neni 10 paragrafi 4 i ligjit me titullin "furnizime të përziera" parashikon se Ministri i Financave cakton me udhëzim nëse një furnizim është furnizim mallrash apo furnizim shërbimesh. Në zbatim të këtij neni të ligjit për TVSH-në, Ministri i Financave ka nxjerrë edhe udhëzimin objekt shqyrtimi. Gjykata vlerëson se parashtrimi i subjektit të interesuar se nëse ka kufizim të veprimtarisë së lirisë ekonomike këtë gjë e ka bërë ligji për TVSH, është i drejtë. Kjo pasi është ligjvënësi,

i cili në nenin 10 paragrafi 4 të ligjit mbi furnizimet e përziera, i jep të drejtën Ministrit të Financave të përcaktojë nëse një furnizim duhet të kualifikohet si furnizim mallrash apo si furnizim shërbimesh për qëllim të regjimit fiskal. Në këtë këndvështrim, në pikën 1 të udhëzimit, ndër të tjera, përcaktohet se "Importuesit dhe prodhuesit që janë furnizuesit primarë konsiderohen si kryesorë, ndërkohë që operatorët që furnizohen prej tyre konsiderohen si agjentë". "Agjenti paraqitet si përfaqësues i kryesorit duke kryer një ndërmjetësim, të konsideruar si furnizim shërbimi".

Neni 50 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" parashikon se kërkesat lidhur me shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare mund të paraqiten brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre. Gjykata vëren se ligji për TVSH-në ka hyrë në fuqi rreth 14 vjet më parë nga data e depozitimit të kërkesës, objekt i këtij shqyrtimi kushtetues, dhe në këto kushte, afati trevjeçar i parashikuar në ligjin e përmendur më sipër ka kaluar. Për rrjedhojë, Gjykata e çmon të bazuar pretendimin e subjektit të interesuar se kërkuesi nuk ka kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit për TVSH-në dhe se ky ligj nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë në këtë çështje.

Në këto kushte, Gjykata vlerëson se udhëzimi nr.18, datë 18.6.2008 i Ministrit të Financave, i dalë në zbatim të ligjit të TVSH-së, sipas parashikimeve specifike të neneve 10/4 dhe 35 të ligjit, nuk cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike të parashikuar në nenin 11/3 të Kushtetutës.

4. Lidhur me pretendimin se udhëzimi, objekt i shqyrtimit kushtetues, cenon nenin 118 të Kushtetutës

Kërkuesi pretendon se udhëzimi nr.18, datë 18.6.2008 nuk respekton kriteret e nenit 118/1 të Kushtetutës, sipas të cilit aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e përcaktuara me Kushtetutë; dhe të nenit 118/2 se ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si edhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. Sipas kërkuesit, ligji për TVSH-në në asnjë pjesë të tij nuk i jep kompetencë Ministrit të Financave të bëjë një rregullim kaq të detajuar, siç është rasti i marrëdhënieve mes furnizuesve të hidrokarbureve.

Lidhur me legjitimimin e kërkuesit *ratione materiae*, Gjykata Kushtetuese, në një rast me pretendime të ngjashme, ka çmuar se kuptimi mbi legjitimimin duhet parë edhe në këndvështrimin e dallimit që ekziston ndërmjet pretendimit për cenim të së drejtës për veprimtari të lirë ekonomike (neni 11 i Kushtetutës) dhe pretendimit për antikushtetutshmëri të aktit nënligjor të kundërshtuar, në kuptim të rregullimit kushtetues të parashikuar nga neni 118 i Kushtetutës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 25.7.2008*).

Gjykata ka konfirmuar se procedurën e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, në aspektin formal, mund ta vënë në lëvizje, për arsye të një interesi publik qoftë dhe pa pasur një interes konkret subjektiv, vetëm subjektet e parashikuara nga neni 134/1, shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç" të Kushtetutës, pasi ky kontroll nuk ushtrohet në lidhje me një të drejtë subjektive të individit, por për një ballafaqim ndërmjet akteve normative me Kushtetutën. Ndërsa të gjitha subjektet e tjera, që parashikohen në nenin 134/1, shkronjat "dh", "e", "ë", "f", dhe "g", kanë të drejtë të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese vetëm nëse ata përmbushin kushtin e kërkuar nga paragrafi 2 i nenit 134 të Kushtetutës, për të argumentuar "interesin e tyre" në një "çështje të veçantë", në lidhje me prerogativën e Gjykatës për të vendosur mbi pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën sipas nenit 131/c të Kushtetutës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 25.7.2008*).

Gjykata, më sipër, lidhur me pretendimin për kufizim të veprimtarisë së lirisë ekonomike u shpreh se, nëse ka një kufizim të kësaj lirie, këtë rregullim e ka bërë ligji për TVSH-në, duke vlerësuar parashtrimin e subjektit të interesuar të drejtë. Bazuar mbi këtë qëndrim, Gjykata e çmon të mbështetur legjitimimin e kërkuesit për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së udhëzimit, objekt i shqyrtimit kushtetues, në lidhje me kriteret e nenit 118 të Kushtetutës.

Neni 118/2 i Kushtetutës parashikon: *"Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjen që duhet rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte."*

Gjykata, në analizën më sipër të pretendimit për cenimin e lirisë të veprimtarisë ekonomike, arriti në përfundimin se udhëzimi nr.18, datë 18.6.2008 i Ministrit të Financave është një akt i dalë në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar". Ky ligj ka autorizuar nxjerrjen e akteve nënligjore nëpërmjet disa dispozitave: neni 35 paragrafi 1 i këtij ligji parashikon se Ministri i Financave është përgjegjës për zbatimin e këtij ligji; neni 35 paragrafi 3 parashikon se për zbatimin e këtij ligji Ministri i Financave nxjerr udhëzimet përkatëse; neni 10 paragrafi 4 i ligjit me titullin "furnizime të përziera" parashikon se Ministri i Financave cakton me udhëzim nëse një furnizim është furnizim mallrash apo furnizim shërbimesh. Gjithashtu, ligji ka përcaktuar si organ kompetent për nxjerrjen e këtyre akteve

nënligjore Ministrin e Financave. Në këto nene janë përcaktuar dhe çështjet që duhen rregulluar nga ky organ dhe konkretisht, ndër të tjera, *përcaktimi me udhëzim nëse një furnizim është furnizim mallrash apo shërbimesh.*

Në çështjen objekt shqyrtimi, Ministri i Financave, në zbatim të dispozitave deleguese të ligjit për TVSH-në, ka nxjerrë edhe udhëzimin nr.18, datë 18.6.2008. Gjykata nuk gjeti argumente që do të mbështetnin pretendimin për shkeljen e kërkesave të nenit 118 të Kushtetutës në nxjerrjen e këtij udhëzimi.

Sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi për mosrespektimin e kritereve të kërkuara nga neni 118 i Kushtetutës nga udhëzimi i Ministrit të Financave nr.18, datë 18.6.2008, është i pambështetur.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja "c" dhe 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës, si dhe në 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të pikës 1 të udhëzimit nr.18, datë 18.6.2008.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi

VENDIM
Nr.29, datë 16.4.2009

PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2009 PËR TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 12, pika 1 dhe 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 16.4.2009, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve mbi përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2009 për të licencuarit në sektorin e energjisë dhe konsideroi të drejtë llogaritjen e pagesave të rregullimit sipas nivelit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2008, nga secili operator i licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2009 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

TABELA E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2009 PËR OPERATORËT

Nr.	Kompania	Pagesa e rregullimit për vitin 2009 (në lekë)
1	ALBANIAN GREEN ENERGY ShPK	300.000
2	BALKAN GREEN ENERGY SHPK	240.000
3	EMIKEL SHPK	35.000
4	AMAL SHPK	11.000
5	SPAHIU-GJANC SHPK	55.000

6	WONDER-POWER SHA	60.000
7	PROJEKSION ENERGJI SHA	10.000
8	SAROLLI SHPK	5.000
9	JUANA SHPK	25.000
10	WTS ENERGJI SHPK	13.000
11	MARJAKAJ SHPK	5.000
12	MAKSI ELEKTRIK SHPK	10.000
13	DARDANIA ENERGJI SHPK	1.000
14	FAVINA 1 SHPK	50.000
15	ENERGO SAS SHPK	10.000
16	REMI SHPK	10.000
17	GSA SHPK	61.000
18	DARFO	50.000
19	OST SHA	5.500.000
20	TEC-I VLORË	4.829.245
21	OSSH SHA	54.312.645
22	KESH SHA	11.651.500
23	HIDROINVEST 1 SHPK	5.000
24	HERA SHPK	10.000
25	ALB WIND ENERGY SHPK	10.000
26	ERS-08 SHPK	5.000
27	BIOPOWER GREEN ENERGY SHPK	10.000
28	UNION EOLICA ALBANIA SHPK	10.000
29	E-VENTO SRL ALBANIA SHPK	10.000
30	ENPOWER ALBANIA SHPK	10.000
31	ALBANIAN GREEN ENERGY SHPK	10.000
32	HEC TERVOLI SHPK	5.000
33	MUSO HEC QYTEZË SHPK	5.000
34	ACR ENERGY SHPK	10.000
35	GEN-I TIRANA SHPK	10.000
36	SPAHIU-GJANC SHPK	10.000
37	UNIVERSI SHPK	10.000
38	ENPOWER ALBANIA SHPK	10.000
	Totali i pagesave të rregullimit	**77.384.390**

UDHËZIM
Nr.11, datë 21.4.2009

PËR PROCEDURAT DHE AFATIN E HEQJES SË ZGJEDHËSVE QË SHËRBEJNË NË FORCAT E ARMATOSURA E NË FORCAT E POLICISE SË SHTETIT, NGA LISTAT E ZGJEDHËSVE TË VENDBANIMIT TË TYRE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 60 pika 3, të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe afatin e heqjes së zgjedhësve, nga listat e zgjedhësve të vendbanimit të tyre, që shërbejnë në Forcat e Armatosura dhe Forcat e Policisë së Shtetit, që do të ndodhen në vendqëndrimet e tyre në ditën e zgjedhjeve.

Neni 2

Kryetarët e njësive përkatëse të qeverisjes vendore, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pasi verifikojnë nëse zgjedhësit e kërkuar janë në listën e zgjedhësve të asaj njësie, marrin vendim për heqjen e këtyre zgjedhësve nga lista e zgjedhësve të vendbanimit të tyre.

Neni 3

Vendimi hartohet në tri kopje, nga të cilat njëra afishohet së bashku me listën përfundimtare të zgjedhësve, njëra ruhet pranë organit vendimmarrës, së bashku me kërkesën e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe kopja e tretë, brenda 2 ditëve nga marrja e vendimit, i dërgohet kësaj të fundit.

Neni 4

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Arben Ristani

UDHËZIM
Nr.12, datë 21.4.2009

PËR CAKTIMIN DHE PËRGATITJEN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, MËNYRËN E NGRITJES SË GRUPEVE TË NUMËRIMIT DHE CAKTIMIN E TAVOLINAVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 93, nenit 94, nenit 95 dhe nenit 96 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat për caktimin e vendndodhjes së vendit të numërimit të votave (VNV), përgatitjen e tyre, si dhe të rregullojë mënyrën e caktimit dhe të ngritjes së grupeve të numërimit (GN) dhe tavolinave të numërimit.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Vendndodhja e VNV-ve caktohet me vendim të KQZ-së, duke pasur për bazë kriteret e këtij udhëzimi.
2. Vendi i numërimit të votave caktohet, si rregull, në ndërtesa publike, si: pallat sporti, pallat kulture, qendër kulturore e fëmijëve, palestra sportive, salla kinemaje, ambiente të përshtatshme shkollash etj.
3. Vendi i numërimit të votave, me autorizim të veçantë të KQZ-së, mund të caktohet edhe në ndërtesa private nëse nuk është i mundur caktimi në ndërtesa publike.
4. Vendi i numërimit të votave nuk mund të caktohet në ndërtesa që përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike apo kandidati, ose të të afërmve të tij.
5. KZAZ-ja organizon dhe përgatit vendin e numërimit të votave.

PJESA II
CAKTIMI I VENDNDODHJES SË VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE (VNV)

Neni 3
Vendndodhja e VNV-së

1. Vendndodhja e VNV-së caktohet me vendim të KQZ-së, jo më vonë se 30 ditë nga data e zgjedhjeve dhe vendoset menjëherë në dispozicion të KQZ-së për instalimin e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

2. Në përcaktimin e vendit të numërimit të votave mund të përzgjidhet bashkia qendër rrethi, pavarësisht nëse ndodhet jashtë juridiksionit territorial të ZAZ-së, ose bashkisë brenda territorit të ZAZ-së, apo edhe në njësinë më të madhe administrative, nëse bashkitë nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 93 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 5 të këtij udhëzimi.

3. Në përzgjedhjen e VNV-së merren parasysh: përparësitë logjistike të transportit rrugor, distanca nga qendrat e votimit, hapësira që ofron salla, si dhe mundësia për aplikimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave.

Neni 4
Kritere teknike të VNV-së

Vendi i numërimit të votave, i përzgjedhur nga KQZ-ja, duhet të plotësojë të paktën kriteret e mëposhtme teknike:

a) Për zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë në përbërje të tyre deri në 79 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 200 m^2.

b) Për zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë në përbërje të tyre mbi 79 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 300 m^2.

c) Të ketë sistem të siguruar e të pandërprerë ndriçimi dhe energji elektrike të mjaftueshme për të suportuar teknologjinë mbështetëse të numërimit të votave si në mjediset e brendshme, ashtu edhe përreth godinës.

d) Të ofrojë mundësitë e instalimit të teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave.

e) Të ketë, për aq sa është e mundur, më shumë se një derë komunikuese me mjedisin e jashtëm.

f) Të jetë e pajisur me mjete të mbrojtjes kundër zjarrit, si dhe të ndihmës së shpejtë.

Neni 5
Organizimi i vendit të numërimit të votave

1. KZAZ-ja organizon dhe përgatit vendin e numërimit të votave, në mënyrë të tillë që të garantojë zhvillimin normal të punës për numërimin e votave.

2. KZAZ-ja organizon hapësirën e VNV-së, në mënyrë të tillë që të jetë e ndarë në mënyrë të qartë nga hapësira për vëzhguesit, kandidatët dhe mediat. Në asnjë rast nuk duhet cenuar mundësia e ndjekjes nga afër e procesit të numërimit dhe shfaqja e fletëve të votimit në monitorët e vendosur për këtë qëllim.

3. Organizimi fizik i hapësirës në dispozicion të çdo grupi numërimi duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të pengojë ndërhyrjen e personave të tjerë të pranishëm në VNV.

4. Menjëherë me marrjen në dorëzim nga KQZ-ja të VNV-së, KZAZ-ja, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, merr masa për krijimin e kushteve të përshtatshme për instalimin e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave. Jo më vonë se pesë ditë para ditës së zgjedhjeve, bëhet rregullimi përfundimtar i VNV-së, sipas planvendosjes orientuese bashkëlidhur këtij udhëzimi, si dhe vendosen pajisjet logjistike të nevojshme për kryerjen e procesit të numërimit, si më poshtë:

a) Tavolina pune dhe 8 karrige për KZAZ-në;

b) Tavolinë pune me 2 karrige për ndihmësit teknikë;

c) Dyshe tavolinash (vendosen sipas shpjegimit në skemën orientuese) me nga katër karrige për çdo tavolinë numërimi të votave;

d) Kompjuter, printer, fotokopje dhe telefon/fax për KZAZ-në;

e) Struktura ndarëse të hapësirës së publikut me hapësirën për numërimin e votave;

ç) Tabelat treguese të dërguara nga KQZ-ja;

f) Tabelat treguese për drejtimin e lëvizjes në mjediset e brendshme të VNV-së.

5. Në çdo rast, organi që administron objektin ku është vendosur VNV-ja, merr masa për sigurimin

e pajisjeve logjistike të parashikuara në germat “a”, “b” dhe “c” të pikës 4 të këtij neni.

PJESA III
NGRITJA E GRUPEVE TË NUMËRIMIT

Neni 6
Caktimi i numrit të grupeve dhe tavolinave të numërimit

1. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë deri në 79 qendra votimi, KZAZ-ja cakton ngritjen e pesë tavolinave të numërimit dhe të dhjetë grupeve të numërimit.

2. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë nga 80 deri në 100 qendra votimi, KZAZ-ja cakton ngritjen e gjashtë tavolinave të numërimit dhe të dymbëdhjetë grupeve të numërimit.

3. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë nga 101 deri në 120 qendra votimi, KZAZ-ja cakton ngritjen e shtatë tavolinave të numërimit dhe të katërmbëdhjetë grupeve të numërimit.

4. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë nga 121 deri në 140 qendra votimi, KZAZ-ja cakton ngritjen e nëntë tavolinave të numërimit dhe të tetëmbëdhjetë grupeve të numërimit.

5. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë mbi 140 qendra votimi, KZAZ -ja cakton ngritjen e dhjetë tavolinave të numërimit dhe të njëzet grupeve të numërimit.

Neni 7
Grupet e numërimit të votave

1. Çdo KZAZ cakton me vendim ngritjen e grupeve të numërimit. Për caktimin e tyre, KZAZ-ja përdor modelin 05 V “Për caktimin e grupeve të numërimit të votave”, miratuar me vendimin nr.14, datë 23.2.2009 të KQZ-së “Për miratimin e modeleve të vendimeve dhe dokumentacionit të punës së KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend, të datës 28 qershor 2009”.

2. Grupet e numërimit të votave janë 2 për çdo tavolinë numërimi. GNV-të numërtohen me numër rendor rritës dhe përfundojnë gjithnjë me numër çift.

3. Një grup numërimi numëron jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 10 qendra votimi.

4. Nëse është e nevojshme, grupet e dyta të numërimit të votave fillojnë punë sapo përfundojnë grupet e para të numërimit të votave.

5. Në çdo rast, grupet e dyta rrinë në gatishmëri dhe zëvendësojnë grupet e para me vendim të KZAZ-së, edhe nëse grupet e para ndërpresin punën për shkaqe të papërligjura.

6. Nëse nuk është e nevojshme, grupet e dyta nuk futen në punë.

7. Çdo grup numërimi përbëhet nga numëruesi i parë, sekretari dhe 2 anëtarë.

Neni 8
Emërimi i anëtarëve të grupeve të numërimit

1. KZAZ-ja, dhjetë ditë para ditës së zgjedhjeve, njofton me shkrim partitë politike të cilave u ka lindur e drejta të propozojnë anëtar të GNV-ve, për numrin e GNV-ve që do të ngrejë dhe i kërkon atyre të dorëzojnë propozimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve, të paktën 4 ditë para ditës së zgjedhjeve.

2. Propozimet për dy nga anëtarët e grupeve të numërimit bëhen nga partitë politike, të cilat kanë kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-së, ndërsa propozimet për dy anëtarët e tjerë të GN-ve bëhen nga partitë politike të cilave u ka lindur e drejta të propozojnë anëtar të GN-ve sipas një akti të veçantë të KQZ-së.

3. KZAZ-ja, jo më vonë se dy ditë para datës së zgjedhjeve, emëron anëtarët e grupeve të numërimit pasi i gjen ato në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 11 dhe 12 të këtij udhëzimi.

4. Për emërimin e anëtarëve të GN-së, KZAZ-ja përdor modelin 06 V “Për emërimin e anëtarëve të grupeve të numërimit të votave”, miratuar me vendimin nr.14, datë 23.2.2009 të KQZ-së “Për miratimin e modeleve të vendimeve dhe dokumentacionit të punës së KZAZ-ve, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 28 qershor 2009”.

Neni 9
Procedura e shortit për numëruesin e parë dhe sekretarin e GNV-ve

KZAZ-ja emëron numëruesin e parë dhe sekretarin e grupeve të numërimit sipas procedurës së mëposhtme:

a) Partia politike, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve "tek" të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve "çift" të numërimit të votave.

b) Partia politike, e cila ka propozuar kryetarin e KZAZ-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve "çift" të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve "tek" të numërimit të votave.

c) Anëtari i tretë dhe i katërt i grupeve të numërimit emërohen nga propozimet e partive politike, të cilave u ka lindur e drejta të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt, sipas shortit të hedhur në KQZ, për çdo ZAZ.

Neni 10

Paraqitja e propozimeve nga partitë politike

Propozimi për emrat e anëtarëve të GN-ve i paraqitet KZAZ-së. Partitë politike mund t'u delegojnë degëve lokale të tyre të drejtën e propozimit për anëtarë të GN-ve. Propozimet duhet, gjithnjë, të shoqërohen me dokumentet e mëposhtme:

a) Certifikatë personale me fotografi;

b) Kopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë.

Neni 11

Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe sekretarit të GNV-së

Anëtari dhe sekretari i grupit të numërimit të votave nuk mund të jetë:

a) deputet ose kandidat për deputet në Kuvend;

b) kryetar bashkie ose komune;

c) ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit ose Shërbimit Informativ Shtetëror;

d) anëtar apo sekretar të një grupi tjetër numërimi.

Neni 12

Kushtet për emërimin e anëtarit dhe I sekretarit të GNV-së

Anëtar dhe sekretar i grupit të numërimit të votave mund të emërohet çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;

b) ka arsim të lartë;

c) është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

e) ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.

Neni 13

Zëvendësimi i anëtarëve të grupit të numërimit

1. Në rast se një parti politike nuk paraqet propozim brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 95 pika 1 të Kodit Zgjedhor, KZAZ-ja me vendim cakton anëtarin zëvendësues.

2. Anëtari zëvendësues caktohet me short ndërmjet anëtarëve të KQV-ve që i përkasin këtij subjekti zgjedhor në zonën e administrimit zgjedhor.

3. Në rast se numri i anëtarëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 12 dhe në nenin 13 të këtij udhëzimi, brenda ZAZ-së, është më i vogël se numri i kërkuar për anëtarët e GNV-ve, KZAZ-ja i kërkon komisionit të administrimit zgjedhor më të afërt, që ndodhet në të njëjtën zonë zgjedhore, të sjellë listën e saj me anëtarët e QV-ve që plotësojnë këto kushte, të propozuara nga subjekti zgjedhor përkatës.

4. Procedura e shortit për anëtarët e GNV-ve, që zgjidhen nga një ZAZ tjetër, është e njëjtë.

5. Partia, e cila ka të drejtën të paraqesë propozimin për anëtarin e tretë ose të katërt të GNV-ve, sipas shortit të hedhur në KQZ dhe nuk ka përfaqësues në KQV, humbet të drejtën të paraqesë anëtar të GNV-ve nëse nuk respekton afatin e parashikuar në nenin 95 pika 1 të Kodit Zgjedhor.

6. Në rast se nuk është i mundur plotësimi i numrit të anëtarëve të grupit të numërimit të votave, ai funksionon me jo më pak se dy anëtarë.

Neni 14

Procedura e shortit për zëvendësimin e anëtarëve të GNV-ve

Procedura e shortit, e hedhur nga KZAZ-ja për anëtarin zëvendësues të GN-ve, është si më poshtë:

a) Sekretari i KZAZ-së përzgjedh të gjithë anëtarët e qendrave të votimit të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 12 dhe në nenin 13 të këtij udhëzimi.

b) Anëtarët e KQV-ve renditen, në mënyrë rastësore, në lista sipas partive politike të cilat i kanë propozuar.

c) Çdo emri, të renditur në secilën listë, i vendoset nga një numër rendor rritës, duke filluar nga 01.

d) Në një enë transparente, vendosen shirita letre ku janë shënuar numrat rendor që i korrespondojnë çdo anëtari të KQV-së së partisë përkatëse të renditur në listë.

e) Kryetari i KZAZ-së tërheq shirita letre në numër të barabartë me numrin e anëtarëve të GNV-ve që mungojnë.

f) Anëtari i KQV-së, i emëruar me propozim të partisë politike për të cilën hidhet shorti, caktohet anëtar i grupit të numërimit.

g) Në rast se partia politike, e cila nuk ka paraqitur propozime për anëtar të GNV-ve dhe nuk ka anëtar në KQV i përket partive të shumicës parlamentare, shorti hidhet ndërmjet anëtarëve të KQV-së, që i përkasin partisë së dytë të shumicës parlamentare e cila ka propozuar anëtar në KQV.

h) Në rast se partia politike, e cila nuk ka paraqitur propozime për anëtar të GNV-ve dhe nuk ka anëtar në KQV i përket partive të opozitës parlamentare, shorti hidhet ndërmjet anëtarëve të KQV-së, që i përkasin partisë së dytë të opozitës parlamentare e cila ka propozuar anëtar në KQV.

Neni 15

1. Në rastet kur vendi i një anëtari të grupit të numërimit mbetet vakant gjatë procesit të numërimit të votave, partia politike e cila kishte propozuar anëtarin, paraqet menjëherë propozimin e ri.

2. Nëse partia politike nuk paraqet propozimin për plotësimin e vendit të mbetur bosh brenda 1 ore, KZAZ-ja zbaton procedurën e shortit sipas nenit 14 të këtij udhëzimi.

Neni 16

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ristani

Zgjedhjet për Kuvend të datës 28 Qershor 2009

LEGJENDA

EMERTIMI	NJESIA	SASIA
TAVOLINA PUNE	Cope	12
KARRIGE	Cope	60 (max)
SHIRIT NDARES	Meter	50 (max)
FAKS	Cope	1
TABELA SQARUESE	Cope	10

TEKNOLOGJI MBËSHTETËSE

PLANVENDOSJE ORIENTUESE
E
VENDIT TE NUMERIMIT TE VOTAVE



UDHËZIM
Nr.13, datë 22.4.2009

PËR PROCEDURAT E AKREDITIMIT DHE RREGULLAT E VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE NGA ORGANIZATAT JOQEVERITARE SHQIPTARE DHE TË HUAJA, ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE, PËRFAQËSUES TË SHTETEVE TË HUAJA DHE MEDIAVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të neneve 6 (pikat 2, 4 dhe 5), nenit 7 dhe nenit 21 pika 1 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

UDHËZON:

PJESA I
QËLLIMI DHE PËRKUFIZIME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim përcakton rregullat për akreditimin, të drejtat dhe detyrat, kriteret dhe standardet për vëzhgimin e zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave.

Neni 2
Kushtet për të qenë vëzhgues

1. Vëzhguesi duhet të propozohet nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 1.
2. Vëzhguesi duhet të plotësojë kushtet për të qenë zgjedhës, si dhe të jetë i padënuar penalisht.

Neni 3
Kohëzgjatja e mandatit të vëzhguesve

1. Vëzhguesit ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me afatet e përcaktuara në autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja.
2. Vëzhgues afatgjatë konsiderohen ata persona, të cilët autorizohen nga KQZ-ja për të vëzhguar procesin nga momenti i akreditimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.
3. Vëzhgues afatshkurtër konsiderohen ata persona, të cilët autorizohen nga KQZ-ja për të vëzhguar procesin nga 72 orë para datës së zgjedhjeve deri në përfundimin e numërimit të votave.

PJESA II
PROCEDURA PËR CAKTIMIN E VËZHGUESVE

Neni 4
Kërkesa për akreditim

Subjektet e përcaktuara në këtë udhëzim, që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet, duhet të paraqesin pranë KQZ-së dokumentacionin si më poshtë:

a) kërkesë nga drejtuesi apo përfaqësuesi i subjektit që kërkon të vëzhgojë procesin zgjedhor, e cila duhet të përmbajë:

- adresën,
- numrin e telefonit,
- informacione të tjera për kontaktim.

b) vërtetimin e regjistrimit në gjykatë ose në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe/ose ftesën përkatëse.

c) lista të veçanta për:

- vëzhguesit afatgjatë (model nr.01-LV),
- vëzhguesit afatshkurtër (model nr.02-LV),
- përkthyesit e propozuar (model nr.03-LP).

Kërkesa për akreditim dhe listat e vëzhguesve sipas pikës "c" paraqiten me shkrim. Kopje të listave në formë elektronike, në programin EXCEL sipas modeleve nr.01-LV, 02-LV dhe 03-LP, bashkëlidhur me këtë udhëzim, duhet të paraqiten së bashku me kërkesën e subjektit.

Neni 5
Përgjegjësitë e subjekteve vëzhguese

Subjektet që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet, janë përgjegjëse:
a) për saktësinë e dokumentacionit të paraqitur;
b) për saktësinë e të dhënave personale të paraqitura për secilin prej vëzhguesve të propozuar.
Subjektet vëzhguese kanë detyrimin t'u bëjnë të ditur përmbajtjen e këtij udhëzimi të gjithë vëzhguesve të tyre.

Neni 6
Afatet

1. Subjektet shqiptare, që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet, duhet të paraqesin kërkesat dhe dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në nenin 4 të këtij udhëzimi, jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjedhjeve.
2. Subjektet e huaja duhet të paraqesin kërkesat dhe dokumentacionin përkatës jo më vonë se 72 orë përpara datës së zgjedhjeve.

Neni 7
E drejta e ankimit

Kundër vendimit të KQZ-së për mosdhënien ose refuzimin e akreditimit të vëzhguesve mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

PJESA III
IDENTIFIKIMI I VËZHGUESVE

Neni 8
Autorizimi i vëzhguesve

1. KQZ-ja pajis çdo vëzhgues me autorizimin përkatës sipas modelit nr.04-AV, bashkëlidhur me këtë udhëzim.
2. Autorizimi është i vlefshëm për njësi zgjedhore, qendra votimi apo vend numërimi të votave sipas shënimit përkatës dhe i jep vëzhguesit të drejtën të hyjë dhe të qëndrojë në ambientet e tyre duke respektuar të drejtat dhe detyrat që u njeh Kodi Zgjedhor, ky udhëzim, si dhe akte të tjera nënligjore të KQZ-së.
3. Autorizimi tregon edhe afatin e vlefshmërisë.

Neni 9
Prezantimi i vëzhguesve

1. Vëzhguesit kanë të drejtë të qëndrojnë në KZAZ, në QV dhe VNV.
2. Ata duhet të paraqiten para komisioneve zgjedhore me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja dhe një dokument identifikimi personal.
3. Sipas rastit, KZAZ-ja ose KQV-ja shënon në procesverbal emrin e vëzhguesit, subjektin vëzhgues që ai përfaqëson, numrin e autorizimit dhe numrin e dokumentit të identifikimit.
4. Në një qendër votimi nuk mund të ketë në të njëjtën kohë më shumë se dy vëzhgues nga i njëjti subjekt vëzhgues i huaj dhe jo më shumë se një vëzhgues nga i njëjti subjekt vëzhgues vendas.
5. Në vendin e numërimit të votave (VNV) nuk mund të ketë më shumë vëzhgues nga një subjekt se sa janë dhe tavolinat e numërimit. Për një tavolinë numërimi nuk mund të ketë më shumë se një vëzhgues nga i njëjti subjekt.
6. Vëzhguesit e huaj mund të shoqërohen nga një përkthyes brenda ambienteve zgjedhore.

Përkthyesi është i pajisur me autorizimin përkatës lëshuar nga KQZ-ja sipas modelit nr.05-AP, bashkëlidhur me këtë udhëzim dhe me një dokument identifikimi personal. Përkthyesi nuk mund të hyjë i vetëm në KZAZ, KQV apo në vendin e numërimit të votave.

PJESA IV
TË DREJTAT DHE DETYRAT E VËZHGUESVE

Neni 10
Të drejtat e vëzhguesve

Vëzhguesit, përveç atyre të parashikuara në nenin 7 pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë edhe këto të drejta:

a) t'i drejtojnë pyetje Komisionit Zgjedhor, pa e penguar në veprimtarinë e tij;

b) të hyjnë dhe të dalin pa pengesa në ambientet zgjedhore.

Neni 11
Detyrat e vëzhguesve

Vëzhguesit, përveç atyre të parashikuara në nenin 7 pika 2 të Kodit Zgjedhor, kanë edhe këto detyra:

a) të mos ndërhyjnë në procesin zgjedhor, në procedurat e ditës së votimit ose në procesin e numërimit të votave, të nxjerrjes së rezultatit dhe aktivitetin e Komisioneve Zgjedhore;

b) të respektojnë rregullat e etikës në ambientet zgjedhore;

c) të mos komentojnë dhe/ose debatojnë vendimet e KQV/KZAZ/GNV dhe procesin e votimit.

PJESA V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ristani

Modeli nr.01-LV

Lista e Vëzhguesve Afatgjatë për akreditim bashkëlidhur me kërkesën Nr.Prot_____, datë___/___/2009 të _____

EMËR	MBIEMËR	SHTETËSI	Dt. Lindje (dd.mm.vvvv)	Nr.Dokument Identifikimi	Zona e Vëzhgimit

MODEL 01-LV

Modeli nr.02-LV

Lista e Vëzhguesve Afatshkurtër për akreditim bashkëlidhur me kërkesën
Nr.Prot_____, datë___/___/2009 të _____

EMËR	MBIEMËR	SHTETËSIA	Dt. Lindje (dd.mm.vvvv)	Nr.Dokument Identifikimi	Zona e Vëzhgimit

MODEL 02-LV

Modeli nr.03-LP

Lista e përkthyesve për akreditim bashkëlidhur me kërkesën Nr.Prot_____, datë___/___/2009 të _____

EMËR	MBIEMËR	SHTETËSIA	Dt. Lindje (dd.mm.vvvv)	Nr.Dokument Identifikimi	Zona e Vëzhgimit

MODEL 03-LP



REPUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE / CENTRAL ELECTION COMMISSION

AUTORIZIM / AUTHORIZATION

Vëzhgues Afatgjatë / Long Term Observer

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 28 qershor 2009 /
Elections for the Albanian Assembly, 28 June 2009

EMRI / NAME
MBIEMRI/ LAST NAME
Organizata/Organization
Nr. rendor / Serial No.

E Vlefshme deri
00 shtator 2009

Kryetari i KQZ
Arben RISTANI
(vula e KQZ) (firma)

MODEL-AV



REPUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE / CENTRAL ELECTION COMMISSION

AUTORIZIM / AUTHORIZATION

Përkthyes / Interpreter

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 28 qershor 2009 /
Elections for the Albanian Assembly, 28 June 2009

EMRI / NAME

MBIEMRI/ LAST NAME

Organizata/Organization

Nr.rendor / Serial No.

E Vlefshme deri:
00 muaji 2009

Kryetari i KQZ
Arben RISTANI
(vula e KQZ) (firma)

MODEL 05-AP

REPUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA

KZAZ / EAZC

AUTORIZIM / AUTHORIZATION

MEDIA / PRESS

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 28 qershor 2009 /
Elections for the Albanian Assembly, 28 June 2009

EMRI / NAME _____

MBIEMRI/ LAST NAME _____

Media _____

E Vlefshme deri:
00 muaji 2009

Kryetari i KQZ
Arben RISTANI
(vula e KQZ) (firma)

MODEL 06-AM

UDHËZIM
Nr.14, datë 24.4.2009

PËR KRITERET PËR ZGJEDHJEN E VENDEVE PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NË FUSHATËN ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 3 pika 5, nenit 77 pika 1, nenit 78 pika 1 dhe 4, nenit 79 dhe nenit 88 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

UDHËZON:

Neni 1
Parime të përgjithshme

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë parimet dhe kriteret që duhen zbatuar për afishimin e materialeve propagandistike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 28.6.2009.

Neni 2

1. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore janë të detyruar për të gjitha vendet publike që do të caktojnë për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore, të përcaktojnë ndarjen e hapësirave në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.
2. Caktimi i vendeve për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore bëhet publik dhe u njoftohet subjekteve zgjedhore jo më vonë se 15 ditë nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

Neni 3
Caktimi i vendeve të afishimit

1. Në caktimin e vendeve publike, për afishimin e materialeve propagandistike, njësitë e qeverisjes vendore duhet të mbajnë parasysh:
a) sheshet publike dhe afërsinë e tyre me qendrën e njësisë administrative përkatëse;
b) rrugët kryesore;
c) vendet e veçanta të caktuara për afishim;
d) mundësinë e ndriçimit.
2. Për partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në Kuvend, vendi dhe sipërfaqja për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore është 50% e sipërfaqes së caktuar, kurse për partitë e tjera parlamentare është 35% e sipërfaqes dhe partive joparlamentare, si dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit u caktohet 15% e sipërfaqes.
3. Brenda secilit prej grupeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni të ruhet barazia në shpërndarjen e vendeve për afishim, të vëna në dispozicion për çdo subjekt zgjedhor.
4. Çdo afishim i materialeve propagandistike jashtë vendeve publike të autorizuara sjell heqjen e tyre nga strukturat e zbatimit të ligjit, në varësi të njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 4
E drejta e ankimit

1. Kundër vendimit të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, subjektet zgjedhore kanë të drejtën e ankimit në KQZ kur vërejnë pabarazi në sipërfaqe, në caktimin e vendeve për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore.
2. KQZ-ja, kur konstaton shkeljet e pretenduara, urdhëron kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore për korrigjimin e pabarazisë në sipërfaqe për afishim të materialeve propagandistike.
3. Vendimi i KQZ-së për korrigjimin e pabarazisë në sipërfaqen për afishimin e materialeve propagandistike duhet të realizohet nga njësia e qeverisjes vendore përkatëse brenda 24 orëve nga marrja e

tij.

Neni 5
Personat juridikë dhe fizikë

Personat juridikë apo fizikë, që ushtrojnë aktivitet në fushën e reklamave në vende publike në territorin e njësisë vendore përkatëse, janë të detyruar që të respektojnë parimet e barazisë në çmim për njësi sipërfaqeje dhe kohë ndërmjet subjekteve zgjedhore, në rastin kur afishojnë materiale propagandistike zgjedhore.

Neni 6
Sanksionet

Në rastet e kundërvajtjeve administrative, KQZ-ja vendos sanksionet administrative të parashikuara në Kodin Zgjedhor.

Neni 7

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ristani

VENDIM
Nr.796, datë 17.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVIZIONIN VENDOR PRIVAT "ETV"
SUBJEKTIT: "ELBASAN TV" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë", të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.779, datë 25.2.2009 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit "Elbasan TV" sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën e qytetit të Elbasanit.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.797, datë 17.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE

PËR RADION VENDORE PRIVATE "RADIO 4"
SUBJEKTIT: "ANTIPATREA RADIO" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë", të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.779, datë 25.2.2009 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit "Antipatrea Radio" sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën e qytetit të Beratit.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.798, datë 17.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE "RADIO JUG"
SUBJEKTIT: "INTELMEDIA" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë", të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.779, datë 25.2.2009 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit "Intelmedia" sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge, për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën e qytetit të Fierit.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.799, datë 17.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE "RADIO TAKE 5"
SUBJEKTIT: "TAKE 5" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë", të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 4.3.3009, sipas vendimit nr.779, datë 25.2.2009 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit "Take 5" sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge, për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën e rretheve Tiranë-Durrës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.800, datë 17.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVIZIONIN VENDOR PRIVAT "TV TELE 4"
SUBJEKTIT: "ANTIPATREA" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi frekuencat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë", të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.779, datë 25.2.2009 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit "Antipatrea" sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën e qarkut të Beratit.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.801, datë 17.4.2009

PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË OPERATORIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV ORA"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë,

radio e televizivë", të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.779, datë 25.2.2009 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit juridik "Ora" sh.p.k. për televizionin privat vendor "TV ORA", me nr.licence 084/TVL, për zonën e qarkut të Vlorës.

2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Licencave, Drejtoria Teknike, Drejtoria Ekonomike për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.802, datë 17.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVIZIONIN VENDOR PRIVAT "TV JUG" SUBJEKTIT: "INTELMEDIA" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, dtë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurt e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 4.3.209, sipas vendimit nr.779, datë 25.2.2009 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1.T'i japë subjektit "INTERMEDIA" sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën e qytetit të Fierit.

2.Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3.Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.803, datë 17.4.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT SATELITOR "TV ALSAT"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv" dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat satelitor "TV Alsat", në fushën e transmetimeve televizive satelitore.

2. Pas heqjes së masës së sigurimit të padisë, subjekti "TV Alsat" të kryejë menjëherë rregullimet përkatëse në strukturën e aksionarëve, sipas përcaktimeve të nenit 20 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar.

3. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

4.Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.804, datë 17.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVIZIONIN VENDOR PRIVAT "TV 7"
SUBJEKTIT FIZIIK: Z.REZART ISUFI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.779, datë 25.2.2009 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit fizik z.Rezart Isufi licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 5 vjetësh, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën e qytetit të Lushnjës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.805, datë 17.4.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE "RADIO LUSHNJA"
SUBJEKTIT FIZIK: Z.EDI HALILAJ

Në mbështetje të ligjit nr.8410,datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.779, datë 25.2.2009 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit fizik Z.Edi Halilaj licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal zonën e qytetit të Lushnjës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.812, datë 17.4.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR "RADIO ALSAT-1"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv", vendimit nr.765, datë 30.1.2009 dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë"

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor "Radio ALSAT-1", për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 7.10.2008 dhe botohet në Fleetoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

KËRKESË

Shtetasi Gjyshi Tofik Ramaj, i datëlindjes 15.9.1966, lindur dhe banues në Bisham të komunës Novoselë, Vlorë, kërkon shpalljen të vdekur të shtetases Shaqe Nazif Ramaj.

KËRKUESI
Gjyshi Tofik Ramaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE ……...……	240 lekë
KODI PENAL …….....……..	226 lekë

Hyri në shtyp më 13.5.2009
Doli nga shtypi më 14.5.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADELPRINT
Tiranë, 2009

Çmimi 40 lekë